



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/14
Datë: 20.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 mars 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për plotësim-ndryshimin e vendimit nr. 01/76 të 21 nëntorit 2018, i ndryshuar me vendimin nr. 06/82 të 28 dhjetorit 2018

1. **Lirohen** nga masa e përcaktuar me pikën 1 të vendimit të Qeverisë nr. 01/76 të 21 nëntorit 2018, i ndryshuar me vendimin nr. 06/82 të 28 dhjetorit 2018, importet e lëndës së parë nga Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina.
2. **Detyrohen** Ministria e Financave dhe Transfereve, Dogana e Kosovës dhe institucionet e tjera relevante të zbatojnë këtë vendim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Deri më 1 prill 2020, Qeveria do të nxjerrë vendim për të shfuqizuar vendimet nr. 01/76 të 21 nëntorit 2018 dhe 06/82 të 28 dhjetorit 2018 dhe për të vendosur masa të reciprocitetit të plotë në marrëdhëniet me Serbinë dhe Bosnjë-Hercegovinën në të gjitha çështjet.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë